



**Drejtuar:** "ERZENI/SH" shpk

**Adresa:** Shkodër , Lagjja Bahçallëk, Rruga Nacionale Shkodër-Tiranë, nr pasurie 17/910, zona kadastrale 8591

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit e zgjedhur në bazë të Nenit 30 të Ligjit Nr. 9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), Kreu IV, Neni 33 është "**Procedurë e Hapur**".

NR. REF-81456-07-31-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "**Paisje dhe Orendi për shkolla, kopshte dhe çerdhe**", duke realizuar sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit

Fondi limit: **41.663.794** ( dyzet e nje milion e gjashtëqind e gjashtedhjetë e tre mijë e shtateqind e nentëdhjetë e kater ) **lekë pa TVSH**

Burimi i financimit: Vënë në dispozicion në Zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës 84 datë 29.12.2016 për "Miratimin e programit buxhetor afat mesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017" konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Tiranë me shkresën nr.prot.154/2 datë 17.01.2017

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **29.08.2018, ora 11:00.**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: **Buletini i Njoftimeve Publike nr.31 datë 06.08.2018**

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1. Operatori Ekonomik "M.LEZHA" shpk** me nr. NUIS J76504013C  
Vlera e ofertës pa TVSH **41.289.171** (dyzet e nje milion e dyqind e tetëdhjetë e nente mijë e njeqind e shtatedhjetë e nje) **lekë**
- 2. Operatori Ekonomik "ERZEN/SH" shpk**, me nr. NUIS J66902027T  
Vlera e ofertës pa TVSH **40.988.045** (dyzet milion e nentëqind e tetëdhjetë e tete mijë e dyzet e pese) **lekë**
- 3. Operatori Ekonomik "MUÇA" shpk** , me nr. NUIS K01421002H  
Vlera e ofertës **0 ( zero) lekë.**
- 4. Operatori Ekonomik "RO-AL" shpk**, me nr. NUIS K42108801C

Vlera e ofertes 0 (zero) leke.

Janë skualifikur ofertuesit e mëposhtëm përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

### **1- Oferta e Operatorit Ekonomik “MUCA” shpk, me vlerë të ofertës 0 (zero) lekë pa TVSH**

Operatori ekonomik “MUCA” shpk, nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën 9, të dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “MUÇA” shpk s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 9, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, (i ndryshuar) dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), e shpall të pavlefshme këtë ofertë, pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

### **2-Oferta e Operatorit Ekonomik “RO-AL” shpk, me vlerë të ofertës 0 (zero) lekë pa TVSH**

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se Operatori Ekonomik “RO-AL” shpk, nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën 9, të dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “RO-AL” shpk s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 9, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, (i ndryshuar) dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), e shpall të pavlefshme këtë ofertë, pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 06.09.2018

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse **nuk ka patur ankesa.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se **Operatori Ekonomik “ERZENI/SH” shpk me adresë:** Shkodër , Lagjja Bahçallëk, Rruga Nacionale Shkodër-Tiranë, nr pasurie 17/910, zona kadastrale 8591 se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme pa TVSH **40.988.045** (dyzet milion e nenteqind e tetedhjetë e tete mije e dyzet e pese ) **lekë , është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, 1001, Tiranë, Sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do te zbatohet parashikimi i nenit 58 të ligjit për prokurimet publike nr.9643 date 20.11.2006.

